



Në mbështetje të nenit 9.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenit 2.3, 2.4, 8,10 dhe nenit 35 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37, Udhëzimit Administrativ 2007/06 si dhe Ligjit mbi procedurat administrative nr. 2005/02-L28 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2009, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE ZYRTARE NË INSTITUCIONET E
KOMUNËS SË RAHOVECIT**

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore, në pajtim me dispozitat kushtetuese e ligjore, përcaktohen dhe sigurohen kushtet për përdorimin e barabartë të gjuhëve dhe alfabeteve zyrtare në institucionet e Komunës së Rahovecit, në ndërmarrjet publike dhe organizatat të tjera që kryejnë punë në interes publik (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 2

Në komunë gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe e gjuha serbe dhe alfabetet e tyre. Gjuhët zyrtare, në përdorimin e tyre, kanë status të barabartë në punët dhe aktivitetet e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të Komunës.

Neni 3

Përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe alfabeti i tyre sikur që është e parashikuar me nenin 2.1 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve është e drejtë e barabartë e pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve.

Neni 4

Çdo qytetar e ka të drejtën lirshëm të shprehet pranë organeve përfaqësuese dhe ekzekutive në gjuhët dhe alfabetet zyrtare të komunës, gojarisht apo në formë të shkruar të jep, kërkojë dhe pranojë informata, të dhëna dhe shkresa zyrtare në kuadër të përgjegjësive dhe fushë veprimtarisë së Komunës.

Neni 5

Gjuhë zyrtare të komunës, kuvendi i komunës, e njeh edhe gjuhën e komunitetit i cili përbën së paku 5% të numrit të përgjithshëm të popullsisë të Komunës.

Neni 6

Gjuha e një komuniteti i cili sipas rezultateve të regjistrimit zyrtar të popullsisë përbën së paku 3% të popullsisë të përgjithshme të komunës, me vendim të kuvendit të komunës, njihet si gjuhë në përdorim zyrtar, në kushtet e përcaktuara për përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.

II. Përdorimi i gjuhëve në institucionet e komunës

Neni 7

Në institucionet e komunës zbatohet barazia e gjuhëve dhe alfabeteve zyrtare.

Komuna, mbi bazat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe Ligjit mbi procedurat administrative, siguron kushtet dhe mekanizmat përkatës për përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.

Neni 8

Në punët dhe aktivitetet e kuvendit të komunës, komiteteve të obliguara, komiteteve të përhershme, komiteteve konsultative dhe komisioneve ad hok të Kuvendit, mbledhjet e rregullta me qytetarë dhe takimet në kuadër të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, pjesëtari i komunitetit pakicë gjuha e të cilit është gjuhë zyrtare në komunë e ka të drejtën që në gjuhën e vet, në mënyrë aktive të merr pjesë në debate dhe plotësisht i barabartë të paraqet ide, propozime dhe vërejtje lidhur me çështjet për të cilat debatohet

Neni 9

Komuna për mbledhjet dhe takimet e cekura në nenin 8, në gjuhët zyrtare siguron materialet të cilat do të shqyrtohen dhe stafin me pajisje teknike për përkthime simultane.

Neni 10

Të gjitha rregulloret, vendimet, aktet tjera dhe ndryshimet e plotësimet e tyre të miratuara në kuvendin e komunës dhe trupat punues të kuvendit nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës.

Versionet e akteve nga paragrafi paraparak i këtij neni janë të barasvlershme.

Në rast të kolizionit apo mospërputhshmërisë të versioneve të përkthyer të akteve të ndryshme, përparësi ka versioni origjinal i aktit përkatës.

Neni 11

Në punët dhe aktivitetet e përshkruara në nenin 8 të kësaj rregulloreje, pjesëtari i komunitetit pakicë gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare në komunë ka të drejtë të përdorë gjuhën e vet dhe në kërkesë të tij komuna siguron materialet të cilat do të shqyrtohen dhe stafin me pajisje teknike për përkthime simultane, nëse kërkohet nga pjesëtari i komunitetit pakicë.

Dokumentet dhe shkresat e dorëzuara nga pjesëtari i komunitetit pakicë sipas paragrafit paraparak përkthehen në gjuhët zyrtare dhe përgjigjet e kërkuara kthehen në formë të shkruar në gjuhën e përdorur nga ana e tij.

Neni 12

Në punët dhe aktivitetet e ekzekutivit të komunës, në të gjitha nivelet, pjesëtari i komunitetit pakicë gjuha e të cilit është gjuhë zyrtare në komunë, në gjuhën e vet mund të drejtohet gojarisht dhe në formë të shkruar për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tij dhe marrjen e informacioneve për interes personal apo për interes të komunitetit lokal si dhe të pranojë shërbime dhe të merr dokumente në gjuhën e vet amtare.

Neni 13

Për realizimin e të gjitha çështjeve dhe ofrimin e shërbimeve në kompetencë të Komunës, e gjithë procedura administrative deri në lëshuarjen e aktit përfundimtar zhvillohet në gjuhën zyrtare në të cilën është iniciuar procedura përkatësisht në gjuhën në të cilën është parashtruar kërkesa.

Neni 14

Komuna siguron shërbimin e nevojshëm funksional për përkthime cilësore të dokumenteve, akteve dhe shkresave mbi bazën rregullave gramatikore dhe sintaksore.

Neni 15

Komuna, në punët dhe aktivitetet e stafit përfaqësues dhe ekzekutivit në përgjithësi, ndërmerr masat e nevojshme dhe siguron ambientin e volitshëm për komunikim me opinionin dhe komunikim të ndërsjellë të zyrtarëve në gjuhët zyrtare të komunës.

Neni 16

Emërtimet zyrtare të organeve, drejtorive dhe shërbimeve të administratës dhe institucioneve shkruhen dhe paraqiten në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 17

Në territorin e komunës mbishkrimet publike, emërtimet e vendbanimeve, shesheve, rrugëve, shenjave topografike dhe vendeve tjera publike shkruhen në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 18

Dokumentacioni i organit përfaqësues dhe ekzekutivit, në gjuhët zyrtare të komunës, evidencohen, klasifikohen, ruhen dhe arkivohen në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

III. Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike**Neni 19**

Në ndërmarrjet publike zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare në Komunë.

Neni 20

Në ndërmarrjet publike çdo qytetar e ka të drejtën të komunikojë, kërkojë dhe pranojë shërbime përkatëse në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 21

Ndërmarrjet publike janë të obliguara që shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre t'iu sigurojnë formularët, njoftimet dhe të gjitha shkresat tjera në gjuhët zyrtare të Komunës.

IV. Përdorimi i gjuhëve zyrtare në arsim**Neni 22**

Në arsimin publik, në mënyrë të barabartë, përdoren gjuhët zyrtare të komunës. Çdo qytetar ka të drejtë të përcaktohet dhe sipas vullnetit për vete dhe fëmijën e vet të zgjedh dhe të regjistrohet në gjuhën zyrtare për mësim.

Neni 23

Në mjediset e banuara me komunitet, gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, në shkollat publike arsimore, pjesëtari i komunitetit në pajtim me vullnetin e vet dhe fëmijës ka të drejtë të shkollohet në gjuhën për të cilën përcaktohet.

E drejta sipas paragrafit paraprak të këtij neni më afërsisht përcaktohet me Udhëzim Administrativ të Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

V. Përdorimi i gjuhëve në media**Neni 24**

Mjetet e informimit dhe komunikimit publik ato elektronike dhe të shkruara, në gjuhët zyrtare të komunës, janë të pavarura dhe autonome.

Neni 25

Komuna siguron lirinë dhe pluralizmin e mjeteve të informimit.

Neni 26

Komuna inkurajon dhe sipas mundësive buxhetore mbështet hapjen e së paku një radiostacioni, një kanali televiziv dhe publikimin e një gazete në gjuhën e komunitetit pakicë, gjuha e të cilit është gjuhë zyrtare e Komunës.

Neni 27

Komuna, sipas mundësive buxhetore, në kuadër të mjeteve elektronike të cilat veprojnë në territorin e komunës, inkurajon dhe mbështet emisionet e caktuara për komunitete pakicë gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

Neni 28

Komuna përkrah aftësimin e gazetarëve dhe personelit tjetër të mjeteve të informimit nëpërmjet organizimit të shërbimit për përkthim dhe sigurimit të dokumenteve të shkruara në gjuhët që përdoren në territorin e Komunës.

Neni 29

Mjetet e informimit në gjuhët zyrtare dhe gjuhët e komuniteteve tjera gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare e kanë lirinë e të shprehurit dhe të drejtën e qarkullimit të lirë të informacioneve, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë publike, integritetin territorial të shtetit dhe kufizimeve të tjera të parapara me dispozita ligjore.

VI. Emri personal**Neni 30**

Çdo qytetar, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe aktet tjera normative komunale, emrin dhe mbiemrin e tij dhe emrat e mbiemrat e fëmijëve ka të drejtë t'i regjistrojë në regjistrat publik, dokumentet për identifikim personal dhe dokumentet të tjera në gjuhët dhe alfabetet zyrtare të komunës.

Neni 31

Pjesëtari i komunitetit pakicë, gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare e komunës, ka të drejtë që në regjistrat publik, dokumentet për identifikim personal dhe dokumentet tjera emrin dhe mbiemrin e tij ta regjistrojë sipas alfabetit gjuhësor të komunitetit të cilit i përket.

VII. Mjetet e rregullta juridike**Neni 32**

Çdo qytetar i cili konsideron se gjuhët në përdorimin zyrtar në komunë nuk promovohen, mbrohen apo nuk e kanë statusin e barabartë të tyre dhe se nuk janë siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, e kanë të drejtën e ankesës kryetarit të komunës i cili përmes shërbimit përkatës vendos për çështjen ankimore.

Pjesëtarët e komunitetit për çështjet nga nenet 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje e kanë të drejtën e ankesës kryetarit të komunës i cili për çështjen e ankesës e njofton kuvendin e komunës.

Qytetari apo pjesëtari i komunitetit i cili është i pa kënaqur me përgjigje në ankesë sipas paragrafëve 1 dh 2 të këtij neni mund të ushtrojë ankesë në Qeverinë e Kosovës - Komisionin e Gjuhëve.

VIII. Zbatimi i Rregullores**Neni 33**

Zbatimin e kësaj Rregulloreje e bënë Drejtoria e Administratës dhe Personelit të Komunës.

Drejtoria e Administratës dhe Personelit, pas përfundimit të çdo viti fiskal, Kuvendit i paraqet raport për respektimin e parimeve të përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare.

IX. Dispozitat kalimtare**Neni 34**

Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit.

01 Nr. _____
Rahovec, 29. 04. 2009

Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa